



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 1077/22

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 24.08.2022

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 Shkronja”f” dhe “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për organizimin e manifestimit “Dita e Dëshmëorve të Kombit të Komunës të Vushtrrisë - 1 Shtatori”, në këtë përbërje:
 - 1.1 Medina Bunjaku – kryesuese
 - 1.2 Benjamin Shala, anëtar
 - 1.3 Gëzim Saraçi, anëtar
 - 1.4 Albiona Isa, anëtare
 - 1.5 Ekrem Miftari, anëtar
 - 1.6 Sami Bislimi, anëtar
 - 1.7 Gëzim Zuçaku, Shoqata Familjet e Dëshmorve “(SHFD), anëtar
 - 1.8 Shaban Haliti, “Shoqata e Invalidve të Luftës”(SHIL), anëtar
 - 1.9 Shaip Hyseni, “OVL-UQK,” anëtar
 - 1.0 Vildane Mulaku, “Shoqata Martirët e Lirisë,” anëtare
 - 1.11 Tahir Krasniqi, “Shoqata e të Burgosurve Politik,” anëtar
2. Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, kryesuese e këshillit organizativ, do të mbaj takime me anëtarët e Këshillit Organizativ për përgatitjet që duhet të bëhen për shënimin e kësaj dite më 01 shtator 2022, koordinoj aktivitetet me akterët tjerë relevant si dhe raportoj me kohë te Kryetari i Komunës lidhur me përgatitjet për organizimin dhe mbarëvajtjen e shënimit të kësaj date të rëndësishme për komunën.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Berit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtoreshës së DKRS
- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1097/22

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 31.08.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e Drejta Banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247 dhe Ligjin e ndryshuar dhe plotësuar Nr.08/L-011, si dhe Vendimin e Ministrit të Ministrisë për Mjedis Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë Nr. 3234/22 të datës 03.06.2022 për vazhdimin e afatit për paraqitje të kërkesave për blerje të banesave publike nga bartësit e të drejtës banesore, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe me kërkesë të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – Departamenti i Planifikimit Hapësinor Ndërtimit dhe Banimit, Divizioni i Banimit datë 25 gusht 2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Ismet Gashi**, Zyra Ligjore - kryesues i komisionit
 - 1.2 **Ahmet Shuku**, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
 - 1.3 **Fadil Selimi**, Drejtorja për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj kërkesat e bartësve të së drejtës banesore në Komunën e Vushtrrisë për të cilat dhënës i banesave janë institucionet publike komunale si dhe për banesat për të cilat është vërtetuar se shitësi i tyre është i panjohur.
3. Komisioni me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me kërkesat në fjalë, do të bazohet në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e Drejta Banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247 dhe Ligjin e ndryshuar dhe plotësuar Nr.08/L-011, si dhe Vendimin e Ministrit të Ministrisë për Mjedis Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë Nr. 3234/22 të datës 03.06.2022 për vazhdimin e afatit për paraqitje të kërkesave për blerje të banesave publike nga bartësit e të drejtës banesore.
4. Kryesuesi i Komisionit ka për obligim që të raportoj në MMPHI - - DPHNB, Divizionin e Banimit mbi realizimin e procesit të shitblerjes së banesave për të cilat ekziston e drejta banesore duke marrë parasysh që Vendimi i Ministrit ka afat kohorë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.



Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës